



E premte, 15 maj 2015

NJOFTIM PËR MEDIA

Publikimi i Raportit Vjetor 2014

Me keqardhje e kemi pranuar lajmin për refuzimin e raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), mirëpo për shkak të transparencës dhe për hir të informimit të saktë ZRRE ka obligim nga legjislacioni në fuqi të publikoj këtë raport. Raporti është i publikuar në faqen elektronike të ZRRE-së www.ero-ks.org.

Pavarësisht pakënaqësive të shprehura nga deputetët, lidhur me vendimet e Bordit të ZRRE-se për çështje të ndryshme, ZRRE dëshiron të theksojë se gjatë marrjes së vendimeve vepron në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, dhe ju bënë thirrje të gjitha palëve nëse kanë ndonjë dyshim mbi vendimet e saj të drejtohen tek gjykatat përkatëse. Të gjitha vendimet janë marrë në përputhje të plotë me ligjin kombëtar dhe me procedurat e ZRRE-së, dhe asnjë nga vendimet e vitit 2014 për tarifa, deri më tani nuk është kontestuar në gjykatë nga asnjë palë.

ZRRE është dhe mbetet institucion shumë i përkushtuar në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, mirëpo edhe mbrojtja e cila mund të ofrohet është e përkufizuar sipas dispozitave të ligjeve përkatëse. Deputetët e nderuar të Kuvendit të Kosovës kanë të drejtën ekskluzive për ndryshim të ligjeve në sektorin e energjisë, dhe si gjithmonë ZRRE do ti përmbahet saktësisht detyrave të reja të mundshme të përcaktuara sipas Ligjit.

ZRRE me përkushtim të lartë ka përgatitur Raportit Vjetor 2014, i cili ka 101 faqe, dhe është munduar të paraqesë çdo informatë të rëndësishme për sektorin e energjisë dhe punën e ZRRE-së. Duhet të kuptohet se pavarësisht Raportit Vjetor, ZRRE ka publikuar çdo Vendim, çdo Rregullë dhe çdo proces të shqyrtimit tarifor në faqen e saj elektronike zyrtare. Gjithashtu ZRRE ka dorëzuar çdo informatë e cila është kërkuar nga palët e interesit, si dhe çdo informatë të kërkuar nga Komisionet e ndryshme të Kuvendit. Çdo palë e interesit, e cila seriozisht e ka përcjell punën e ZRRE-së, ka pasur mundësi të njoftohet në mënyrë të hollësishme mbi të gjitha aspektet e sektorit energjetik.

Duke pasur parasysh rolin e ZRRE-së në rregullimin e sektorit energjetik, ku për shumicën e çështjeve nevojitet aprovimi i ZRRE-së, dhe pasi që ZRRE në vazhdimësi publikon çdo vendim të saj, atëherë rrjedhimisht çdo informatë për sektorin e energjisë mund të gjendet në faqen zyrtare të ZRRE-së. Po ashtu për sqarim të opinionit nevojitet të theksohet se të gjitha detajet rreth shqyrtimeve tarifore, duke përfshirë edhe shqyrtimet e vitit 2014 janë të publikuara. Në këto dokumente mund të shihet qartë çdo informatë mbi çdo kosto të energjisë elektrike. Për shkak të kompleksitetit të punës së ZRRE-së, në këto raporte informatat janë të detajuara sipas rregullave në fuqi dhe është e natyrshme se jo çdo konsumator mund të analizoj çdo detaj. Mirëpo, të paktën deputetët e nderuar dhe partitë e ndryshme politike kanë ekipe të posaçme të cilat mund të jenë edhe më të mëdha në numër se sa i gjithë stafi i ZRRE-së, dhe këto ekipe mund të analizojnë Vendimet e ZRRE-së dhe vlerësojnë nëse janë shkelur dispozitat ligjore, kur edhe mund t'i hapet rruga organeve të gjyqësisë të marrin vendim mbi këto pretendime.



ZRRE-ja financohet vetëm nga fonde të dedikuara, të cilat paguhen nga sektori i energjisë. ZRRE nuk pranon grante qeveritare nga Buxheti i Kosovës, edhe pse gabimisht me vite paraqiten si të tilla në Ligjin për Buxhetin e Kosovës, përkundër sqarimeve tona të vazhdueshme. Ligji për Rregullatorin e Energjisë përcakton se ZRRE duhet të mbledh të hyra vetëm për nevojat dhe veprimtarinë e saj, dhe për asnjë arsyeje tjetër. Për shkak të kufizimeve buxhetore (të cilat bien ndesh me dispozitat ligjore), në mbledhjen e të hyrave për vitin përkatës, ZRRE mbledh vetëm aq sa është e lejuar sipas Ligjit të Buxhetit të Kosovës. Për këtë arsye ZRRE është e obliguar të liroj të licencuarit nga taksat e mëtutjeshme që janë të dedikuara për financim të ZRRE-së.